



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

DREJTORIA PLANIFIKIMT KONTROLLIT ZHVILLIMIT TERRITORIT

Nr. _____ Prot

Laç, më ____/____/ 2017

SPECIFIKIME TEKNIKE

Prishja e shkolles se vjeter ne Fushe Mamurras

Bazuar në ankesat e qytetareve të Njesise Administrative Mamurras , te kolektivit mesues nxenes te Shkolles 9 vjecare Fush Mamurras , si dhe ne rrezikun real qe paraqet shkolla e vjeter ne F Mamurras , lind nevoja e prishjes se kesaj ndertese te amortizuar totalisht dhe rrezik per nxenesit dhe banoret . Prishja , pastrami I mbeturinave dhe sistemimi I sheshit do tu ktheje nxenesve te kesaj shkolle rreth 1300 m2 oborr te munguar deri me sot .

Shembja e mureve me kalimin e kohes ka bere qe soleta e pambeshtetur totalisht te jete rrezik serioz per nxenesit e moshave te ndryshme .

Shkolla e vjeter eshte ne forme U me gjatesi totale 110 ml dhe gjeresi 7m , ze nje asip sheshi 1300 m2 .

Prishja ne afersi te shkolles se re ekzistuese do te kryhet me shume kujdes pasi eshte pothuajse ngjitur me te . Heqja e soletave te paranderura mund te kryhet nje nga nje pasi eshte e mundur . Shembja e mureve do te kryhet me eskavator nga jashte brenda , mqse objekti kufizohet me parcela te mbjella . Gjate kohes se prishjes e te ngarkimit te materialit ne kamiona propozojme lagje me uje , pra te jete nje autobot uje gjendje deri ne fund te prishjes dhe ngarkimit ne mjet.

Nuk lejohet prishja e objektit duke filluar nga themeli , por themeli do te jete I fundit qe prishet per efekt nivelimi te sheshit qe del nga prishja e ngrhines se mbetur .

Shkarkimi I materialeve ne toke do te kryhet ne bashkepunim te ngushte me Nj Adm Mamurras dhe inspektoret e mbrojtjes se ambientit .

Realizimin e ketyre punimeve sipas preventivit , mendojme te realizohet ne kohe te shkurter mbasditeve me dy eskavatore te paisur me cekic pneumatic ,4 kamione te tonazheve mbi 10 ton ,gazogjen per prerjen e hekurave ,autobot uji me presion , grejder per sistemin e nivelimin e sheshit .

Objekti do te jete I rrethuar me rrjete plastike per te penguar pluhtrat dhe levizjen e lire te njerezve te pa pune . Duhet te zbatohen rreptesisht rregullat e sigurimit teknik ne pune .

Keto punime duhet te kryhen per nje afat 5 dite .

Distanca vajtje e shkarkimit te materialeve mendojme te jete 5 km.

Per te realizuar keto punime mendojme se duhen gjithsej 20 punonjes te regjistruar ne regjistrat e sig shoqerore dhe te sigurimit teknik : nga keto nje ing. Ndertimi si drejtues teknik si dhe manovratore e saldator me deshmitte perkatese per manovrimin e makinerive e paisjeve .

Per kryerjen e ketyre punimeve mendojme qe licensa e duhur duhet te permbaje :

- 1) NP – 1 A “Punime Gërmimi në tokë
- 2) Punime prishje NS-1
- 3) Ndertime civile e industriale NP-2

Nje inxhinjer ndertimi , drejtues I punimeve

3{ tre} Manovratore te paisur me leje drejtimi e manovrimi

Nje saldator I paisur me dokumentacion te nevojshem

Nje saldatrice

Nje autobot uji

Nje greider nivelues

Nje aparat gazogjeni

Dy eskavatore me goma ose me zinxhire

Dy kamjone mbi 10 ton

Afati I mundshem I kryerjes se punimeve : 5 dite pune

